



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

ANALIZA VJETORE E VITIT 2024

Analizë vjetore mbi punën e bërë gjatë vitit 2024 dhe detyrat për vitin 2025

Gjatë vitit 2024 veprimtaria e Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhe është fokusuar kryesisht në realizimin e objektivave, implementimin dhe zbatimin e prioriteteve dhe politikave të Qeverisë. Gjithashtu është ndërtuar një klimë e favorshme bashkëpunimi me organet qendrore në nivel vendor si dhe me organet e vetqeverisjes vendore, duke bashkërenduar gjithashtu veprimtaritë e tyre, me qëllim realizimin e objektivave në fushën e ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, ofrimin e shërbimeve arsimore dhe shëndetsore cilësore si dhe monitorimin e çdo lloj veprimtarie ligjore të institucioneve në qark.

1- Mardhëniet e Prefektit të Qarkut me Administratën Qendrore dhe Vendore

Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë gjatë vitit 2024 ka qënë maksimalisht i angazhuar në dhënien e suportit në procesin e rindërtimit, në luftën kundër kanabisit, mbarëvajtjen e sezonit turistik veror, arsimin, siguria ne shkolla etj, duke luajtur kështu një rol kryesor në menaxhimin e situatave dhe koordinimin e veprimeve me anë të mekanizmave ligjore dhe Task-Forcave të krijuara në këtë kuadër. Gjithashtu ka ndjekur në vijmësi të gjitha praktikat e ndjekura nga ana këshillave bashkiakë në zbatim të vendimeve të Qeverisë për rindërtimin deri në zbatimin konkret të tyre.

Në këtë kuadër Institucioni i Prefektit të Qarkut ka:

- Zbatuar Urdhërat dhe Udhëzime te ardhura nga autoritetet qendrore.
- Koordinuar punët dhe bashkërenduar veprimtarinë me Degët Territoriale që veprojnë në Qark.
- Koordinuar veprimtarinë ndërmjet Degëve Territoriale si dhe të këtyre të fundit me Organet e Vetëqeverisjes Vendore.

- Dërguar informacione, raporte periodike në Këshillin e Ministrave për veprimtarinë e Degëve Territoriale, sipas Urdhërit të Kryeministrit si dhe për probleme të veçanta, sipas Urdhërit të Ministrit.
- Dërguar informacione, raporte mujore në Ministrinë e Brendshme sipas Urdhërit të Ministrit të Brendshëm dhe për probleme të veçanta.
- Parandaluar dhe menaxhuar situata të natyrave emergjente si përmbytjet, rënia e zjarreve, lufta kundër kanabisit dhe trafikimit të qenjeve njerëzore si dhe ekstemizmit të dhunshëm.

2-Drejtimi i Task-Forcave, Komiteteve dhe grupeve të punës për çështje të caktuara

Pranë Institucionit të Prefektit në zbatim të nenit 14 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, dhe akteve ligjore dhe nënligjore gjatë vitit 2024 janë ngritur dhe kanë funksionuar disa Task - Forca, Komitete dhe grupe pune për problematika të ndryshme, veçanërisht ato në shërbim të komitetit si:

- Emergjencat Civile.
- Luftës kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit si dhe trafikimit të qenjeve njerëzore.
- Luftë kundër ekstemizmit të dhunshëm.
- Siguria në shkollë, siguria ushqimore dhe mjedisi.
- Menxhimi i stacioneve të plazheve, vendqëndrimet e mjeteve ujore motorike si dhe monitorimi i subjekteve që krijojnë zhurma akustike.

4-Mjedisi

Që në prag të hapjes së sezonit turistik për vitin 2024, Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë, në zbatim të urdhërit të Kryeministrit si dhe të Ministrisë Kultures dhe Turizmit me moton “Shqipëria e pastër”, në bashkëpunim të ngushtë me bashkitë e qarkut si dhe institucionet vendore ka hartuar një plan konkret pastrimi, duke evidentuar zonat problematike me shkallë të lartë ndotje në qarkun Lezhë.

Në këtë plan janë caktuar zonat dhe grupet e punës sipas një grafiku të caktuar mujor. Në zbatim të këtij plani Prefekti i Qarkut Lezhë, ka organizuar me një pjesëmarrje të gjërë të punonjësve të administratës shtetërore aksionin e pastrimit të komplet vijës bregdetare të plazhit “Tale”, vijës bregdetare “Kune-Vajin” si dhe grykëderdhja e lumit “Drin”. Kjo nismë pastrimi është organizuar dhe ndjekur paralelisht gjatë gjithë vitit nga N/Prefekti Mirditë dhe N/Prefekti Kurbin në dy bashkitë respektive Mirditë dhe Kurbin. Në bashkëpunim me bashkitë e qarkut, Ins.Shtetëror të Mbikqyrjes së Tregut dhe Agjensinë Rajonale të Mjedisit janë marrë masat e nevojshme si në drejtim të sensibilizimit po ashtu të inspektimeve monitoruese të vazhdueshme në lidhje me përdorimin e qeseve plastike të biodegradueshme nga subjektet dhe qytetaret në të gjithë territorin e qarkut Lezhë.

4-Arsimi

Gjatë muajit shtator dhe me herët, Institucioni i Prefektit në zbatim të politikave të Këshillit të Ministrave në fushën e arsimit dhe në zbatim të Ligjit Nr.107/2016“Për Prefektin e Qarkut” neni 8 pika “g” dhe “b”, ndoqi në vazhdimësi procesin e përgatitjeve për fillimin e mbarë të vitit të ri shkollor 2024-2025. Nga organet e pushtetit vendor janë marrë masat e duhura për krijimin e ambienteve dhe kushteve për mbarvajtjen e mësimin në klasa duke ndërtuar ambiente të reja mësimdhënie si dhe duke nderhyrë në rikonstruksionin e ambienteve të amortizuara gjatë kohës.

- Paketa e sigurise ne shkolla

Ne zbatim te shkreses se Ministrise se Brendshme nr.9298 dt.04.09.2023 “Mbi paketen e sigurise ne shkolla”, kemi ngritur urdherin e Prefektit te Qarkut nr.55 dt.06.09.2023 “Per ngritjen e task-forces per garantimin e sigurise ne shkolla” si dhe plani i masave ne zbatim te tij. Ne zbatim te urdherit te Prefektit u kryen gjithsej ne qark rreth 41 inspektime nga AKU, 20 inspektime nga IKMT- Lezhë si nga komisarjatet e policise Lezhe, Kurbin dhe Mirdite është mbajtur nën kontroll perimetri i sigurise në shkolla për parandalimin veprave që çenojnë sigurinë në këto institucione.

5-Turizmi

Gjatë vitit 2024, një vëmendje e veçantë është treguar për turizmin, si një ndër resurset më të mëdha të të ardhurave në qark. Kemi ndjekur ecurinë e sezonit turistik veror, që nga përgatitjet e në vazhdimësi, duke organizuar takime ndërinstytucionale me fokus turizmin, e më konkretisht:

- Në zbatim të urdhrin të Kryeministrit nr.69, datë 30.03.2024 “Për ngritjen e task forcës ndërinstytucionale të sezonit turistik veror 2024”, me *urdhrin nr.35, datë 10.05.2024 të Prefektit u ngrit task forca vendore ndërinstytucionale në nivel qarku*. Krahas analizës mbi punën e bërë gjatë vitit 2023 dhe në muajt e parë të vitit 2024 nga bashkitë e qarkut dhe degët territoriale u kerkua përmbushja e detyrimeve të tyre në kuadër të ligjit për turizmin dhe akteve nënligjore, u kerkua marrja e masave për një bashkëpunim e koordinim më të mirë ndërinstytucional në vazhdimësi. Në këtë takim ndër të tjera u miratua plani i masave për sezonin turistik 2024.

Me datë 30.04.2024, u zhvillua mbledhja e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit (KRZHT), ku u diskutua ecuria e sezonit turistik dhe u prekën një sërë problematikash të lidhura me monitorimin e hapësirave ujore të lejuara për notim, vendbazimet e mjeteve lundruese, sigurinë ushqimore, etj.

Për sezonin turistik 2024 numri i kontratave me subjektet private për ushtrimin e veprimtarisë si stacione plazhi ka qënë 151, prej të cilave 110 janë kontrata të reja të lidhur në vitin 2024.

6-Mbrojtja Civile

Gjatë vitit 2024 në qarkun Lezhë kemi patur **690 raste zjarresh**. Krahasuar me vitin 2023 kemi patur **83 raste më shumë**, me një sip. të përshkruar nga zjarret rreth **3802.6 ha** dhe të djegur plotësisht një sip. prej **1187.8 ha**, të ndara sipas bashkive të qarkut Lezhë si më poshtë:

Bashkia Lezhë: sip. e përshkruar nga zjarri 2818.8 ha, sip.e djegur nga zjarri 1076.9 ha

Bashkia Mirditë: sip. e përshkruar nga zjarri 816.7 ha, sip.e djegur nga zjarri 33.1 ha

Bashkia Kurbin: sip. e përshkruar nga zjarri 167 ha, sip.e djegur nga zjarri 77.8 ha

Raste që duhen përmendur janë zjarret me permasa të mëdha gjatë sezonit veror në Njësinë Adm.Shëngjin dhe fshatin Lajthizë, Bashkia Mirditë ku falë rolit kordinues të Prefektit të Qarkut Lezhë me bashkitë respektive si dhe me mbashtetjen e fortë të strukturave të AKMC-së u mundësua ndërhyrja nga ajri në 5 raste duke vënë në lëvizje mekanizmin European të Mbrojtjes

Civile me dy avione “Canadir” dhe dy avione “Spartan”, të cilët mundësuan shuarjen e zjarreve pa humbje në jetë njerëzish. Një rol të reëndësishëm në këto situata ka dhe Ministria e Mbrojtjes e cila ka mundësuar ndërhyrjen për fikjen e zjarreve nga ajri me helikopter, me mjete zjarrëfikëse si dhe me 348 efektivë për ndërhyrje në terren.

Gjatë vitit 2024 në qarkun Lezhë kanë rënë rreth **1448 mm shi**, kryesisht gjare muajve mars, maj dhe dhjetor. Nga kjo sasi reshjesh nuk kemi patur përmytje në toka bujqësore, por vetëm në zona urbane kemi patur prezencë të ujit kryesisht në rrugë. Ky fakt tregon se nga Drejtoria Rajonale e Kullimit Lezhë, strukturave bashkiake janë marrë masat e nevojshme për pastrimin e kanaleve dhe mirëmbajtjen e argjinatuarave.

Tabela me të dhënat e krahasuara për vitet 2023 dhe 2024 për qarkun Lezhë :

Nr	Problematika e trajtuar	Të dhënat për vitin 2023	Të dhënat për vitin 2024	Raporti i të dhënave
1	Buxheti	Realizuar në masën 88 %	Realizuar në masën 91 %	+ 3%
2	Vendime të NJV	349 akte/ konfirmuar 348 /kthyer për rishqyrtim 1	256 akte/ konfirmuar 245 /kthyer për rishqyrtim 11	- 93 akte
4	Shkresa	531 shkresa	1154 shkresa	+ 623 shkresa
5	Leje drejtimi të huaja	197 leje drejtimi	182 leje drejtimi	- 15 leje drejtimi
6	Dok.të legalizaura	1624 dokumenta	690 dokumenta	- 934 dok
7	Zjarret	607 raste zjarresh	690 raste zjarresh	+ 83 zjarre
8	Sip.të përmytura	1200 ha tokë	0 ha tokë	- 1200 ha tokë
9	Vep.pen.në fushën e trafik. të personit	0 raste	0 raste	0 raste
10	Vepra penale në fushën e traf. të narkotikëve.	- Evidentuar 153 raste	- Evidentuar 46 raste	- 107 vepra penale
		- Zbuluar 35 raste	- Zbuluar 24 raste	- 11 vepra penale
		- Asgjësuar 61239 rrënjë	- Asgjësuar 15256 rrënjë	- 45983 rrënjë

1- SEKTORI MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE

Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara , në zbatim të ligjit nr.107/2016 “Për prefektin e qarkut”, dhe akteve të tjera në fuqi që normojnë veprimtarinë e tij, gjatë vitit 2024, ka përmbushur këto angazhime kryesore:

Ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me institucionet e administratës shtetërore që veprojnë në qark, për monitorimin e shqyrtimin e veprimtarisë së tyre.

Ka realizuar raportimin dhe informimin pranë institucioneve qendrore (Kryeministrisë, Ministrisë së Brendshme, etj) mbi veprimtarinë e institucionit të Prefektit, mbi veprimtarinë e degëve territoriale, bazuar në të dhënat e marra e të përpunuara.

Ka bashkëpunuar, bashkërenduar veprimtaritë ndërmjet administratës rajonale/vendore dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore, në kuadër të mirëfunksionimit të komiteteve, task forcave, grupeve të punës, tryezave teknike, të drejtuara nga Prefekti, apo ku institucioni i Prefektit është pjesëmarrës, si dhe realizimit të përgjegjësisë që kanë konform legjislacionit në fuqi.

Ka ndjekur funksionimin e organeve të vetëqeverisjes vendore, përsa i përket transparencës me publikun, akteve normative të nxjerra, respektimin e afateve për depozitim te Prefekti, etj.

Ka trajtuar ankesat e komunitetit për shërbimet publike.

Kështu, gjatë vitit 2024:

Marrëdhëniet / korrespondenca me institucionet dhe shtetasit

Janë trajtuar 647 shkresa të ardhura e janë trajtuar 701 e-mail. Këto kanë qënë kryesisht nga institucionet qendrore, administrata shtetërore në qark, njësitë e vetëqeverisjes vendore, strukturat e policisë dhe strukturat e mbrojtjes, në kuadrin e dërgimit të të dhënave të kërkuara, raportimeve e informacioneve. Një numër i kufizuar ka qënë për problematika të shtetasve rreth shërbimeve sociale e publike, ku nga ana jonë janë sqaruar e orientuar shtetasit për zgjidhjen e shqetësimeve të paraqitura.

Nga ana tjetër, në vazhdimësi, SMKVFDD ka realizuar në mënyrë cilësore dhe korrekte korrespondencën në formë shkresore dhe elektronike me Kryeministrinë, Ministrinë e Brendshme apo Ministrinë e tjera, sipas formateve dhe në frekuencat e kërkuara, Kështu, çdo javë janë dërguar përkatësisht raportit mbi veprimtarinë e institucionit pranë Ministrisë së Brendshme; Raporti javor i situatës pranë Zyrës Operacionale të Situatës në Kryeministri.

Për periudhën Qershor-Tetor janë dërguar pranë Ministrisë së Brendshme dhe Kryeministrisë edhe informacionet për ecurinë e sezonit turistik, ndërsa gjatë gjithë vitit informacionet e përditësuara për zbatimin e planit të masave për garantimin e sigurisë në shkolla.

Vend të rëndësishëm në punën tonë kanë përpilimi dhe dërgimi çdo muaj i Raportit final mbi aktivitetin e institucionit të Prefektit pranë Ministrisë së Brendshme; Raportit mujor mbi funksionimin e problematikave të degëve territoriale: Raportit mujor, si dhe 3/6/9/12 -mujore mbi veprimtarinë e Task Forcës Vendore Antikanabis dërguar në MB, TFQ, Raportit 3/6/9/12 mujor mbi zbatimin e planit të veprimtarisë kundër trafikimit të qënieve njerëzore, Raportit mbi zbatimin e planit të veprimtarisë për parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, etj.

Çdo muaj është dërguar pranë Kryeministrisë, Raportit mujor mbi veprimtarinë e Institucionit të Prefektit si dhe institucioneve vendore /rajonale që veprojnë në qark.

Marrëdhëniet me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

Kemi ndjekur publikimet në faqet e internetit të NJVV dhe rrjetet e tyre sociale për zbatimin e detyrimit ligjor që kanë këto organe lidhur me transparencën ndaj komunitetit.

Kemi monitoruar e asistuar përgatitjen e raporteve mbi zbatimin e strategjisë kombëtare të turizmit.

Në bashkëpunim me sektorin juridik dhe të financës e shërbimeve mbështetëse kemi trajtuar 87 akte normative të njëjësive të vetëqeverisjes vendore.

Bashkëpunimi me NJVV ka qënë në rritje edhe përsa i përket mbarëvajtjes së punës së komiteteve rajonale, task forcave, grupeve të punës, të ngritura nga Prefekti, dhe jo vetëm.

Marrëdhëniet me degët territoriale

Kemi përditësuar në vazhdimësi bazën e të dhënave mbi organizimin dhe funksionimin e degëve territoriale, gjë që na ka shërbyer për vlerësimin e situatës aktuale në këta sektorë, arritjet, risitë si dhe pasurimin e të dhënave që raportojmë pranë Kryeministrit, Ministrisë së Brendshme e ministrive të tjera, sipas detyrimeve tona ligjore.

Rëndësi i është kushtuar edhe evidentimit të problematikave në bashkëpunimin ndërmjet këtyre strukturave dhe bashkive, ku ka rezultuar përgjithësisht një bashkëpunim i mire.

Si problematikë në këtë proces do të veçoja bashkëpunimin jo në nivelin e duhur të disa institucioneve vendore/rajonale, të cilët neglizhojnë në kryerjen e raportimeve periodike pranë Institucionit të Prefektit. Megjithatë duhet thënë që për vitin 2024, kjo situatë ka qënë në përmirësim.

Ndjekja e sezonit turistik 2024

Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar dhe legjislacionit në fushën e turizmit, me datën 30.04.2024, nën drejtimin e Prefektit u zhvillua takimi i përbashkët i Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit (KRZHT) dhe drejtues të institucioneve rajonale/vendore që kanë në fushën e tyre të përgjegjësisë detyra lidhur me turizmin. Në këtë takim u analizua puna e bërë në sezonin turistik të vitit të mëparshëm dhe përgatitjet për sezonin e ri turistik 2024.

Bazuar në Urdhrin e Kryeministrit, nr.69, datë 30.04.2024 "Per ngritjen e Task-Forcës Nderinstitucionale te sezonit turistik vendor 2024", Prefekti i qarkut ka nxjerrë urdhrin nr. 35, datë 10.05.2024 “Për ngritjen e Task Forcës Vendore Ndërinstitucionale të Sezonit Turistik Veror 2024 (TFVNST) për qarkun Lezhë”. Janë zhvilluar takime të herëpashershme me anëtarët e TFVNST, ku jemi njohur me ecurinë e sezonit turistik dhe problematikat e hasura. Është monitoruar në vazhdimësi veprimtaria e të gjithë aktorëve pjesë e TFVSTV 2024 dhe janë informuar instancat përkatëse.

Me inicimin e prefektit, një grup pune i administratës së Prefektit ka kryer monitorime në terren ku në rastet e konstatimit të grumbullimit të mbetjeve në zonat turistike janë njoftuar strukturat përgjegjëse dhe është bërë eliminimi i tyre.

Jemi njohur e kemi ndjekur zbatimin e kalendarit të aktiviteteve kulturore, të traditës etj, në rang qarku, organizuar nga bashkia Lezhë me turistët e vizitorët e zonave turistike.

Nën drejtimin dhe koordinimin e prefektit, në përgjigje të situatës së zjarrit të krijuar në masivin pyjor në plazhin e Shëngjinit, si dhe bazuar në Planin kombëtar të mbrojtjes civile, u bë e

mundur shuarja e zjarrit në përmasa të mëdha, në periudhën nga data 27 – 31 korrik 2024. Kjo situatë çënoi përkohësisht mbarëvajtjen e sezonit turistik veror, e cila në vazhdimësi me punën e bërë nga strukturat e ngarkuara me ligj, pati tregues në përmirësim.

Për sezonin turistik 2024 numri i kontratave me subjektet private për ushtrimin e veprimtarisë si stacione plazhi ka qënë 151, prej të cilave 110 janë kontrata të reja të lidhur në vitin 2024.

Nga bashkia Lezhë janë parashikuar 53 parcela si plazhe publike, dhe është respektuar raporti për sipërfaqet në mësh plazheve publike e stacioneve të plazhit. Nga monitorimet e realizuar në të gjitha zonat bregdetare nën juridiksionin territorial të Bashkisë Lezhë nuk është konstatuar zënia e këtyre të fundit dhe gjatë gjithë kohës këto të fundit kanë qënë të aksesueshme për publikun.

Problematikë lidhur zonat bregdetare mbetet siguria e tyre, ku nga ana e bashkisë nuk janë marrë masa për pajisjen e tyre me vrojtues plazhi, apo më informimin e publikut që këto stacione plazhi nuk e ofrojnë shërbimin e vrojtuesit të plazhit. Gjithashtu problematikë tjetër është edhe aksesimi i plazheve publike, pasi vendi në të cilin janë përcaktuar nuk është lehtësisht i aksesueshëm nga ana e publikut.

Referuar të dhënave të dërguara nga ana e Bashkisë Lezhë dhe Agjencisë Rajonale të Bregdetit (ARB) të ardhurat nga pagesa e tarifës së zënies së hapësirës publike për qëllim shfrytëzimi si stacion plazhi nga subjektet rezulton në masën 64.000.000 lekë. Në krahasim me sezonin turistik 2023 ku u realizuan 51.981.350 lekë të ardhura, rezulton me rritje në masën 9.981.827 lekë ose 20%.

Nga asetet që po marrin tepër turistë, bregdeti i Shëngjinit vjen i pari që është i kompletuar me një sërë shërbimesh, pastaj Monumenti i Ranës së Hedhun, Fishta, Memoriali i Skënderbeut. Në total numri i turistëve ka qënë rreth 1.4 milion turistë.

Është punuar dhe realizuar mbajtja pastër e plazheve ku janë angazhuar dhe 20 punonjës shtesë.

Siguria, rendi, zbatimi i planeve të veprimt antikanabis e antitrafik

Kështu për vitin 2024 janë këto tregues përse i përket **rendit dhe sigurisë**:

Nr	Rendi dhe siguria	Viti 2023	Viti 2024	Krahasimi
1	Vepra penale referuar ne prokurori gjithsej	1577	1744	+ 167
2	Zbuluar	1340 /85%	1622 / 93%	+ 282
3	Numri i personave të perfshirë	1372	1541	+ 169
4	Arrestuar	359	341	-18
5	Ndaluar	92	57	-35
6	Ndiqen në gjendje të lirë	807	1042	+ 235
7	Shpallur në kerkim	114	102	-12
8	Ngjarje aksidentale	89	118	+29
9	Dhunë në familje	82	90	+8
10	Urdhër mbrojtje	92	67	-25
11	Krime mjedisore	61	16	-45

Ka funksionuar *Task Forca Vendore Antikanabis*, bazuar në urdhrin nr. 51 datë 13.04.2017 të Kryeministrit “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave drejtuese dhe koordinuese

ndërinstitucionale në nivel qendror dhe vendor, të ngarkuara me përgjegjësinë e zbatimit të planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, 2024-2025”, dhe urdhrin nr. 8, datë 27.01.2020 të prefektit të qarkut Lezhë, “Për ngritjen e TFV antikanabis”.

Task forca vendore antikanabis, me frymë bashkëpunimi dhe bashkëveprimi ka realizuar menaxhim dhe kontroll të vazhdueshëm të territorit të qarkut, në funksion të parandalimit të kultivimit të bimëve narkotike denoncimit dhe evidentimit të rasteve.

Nën drejtimin e Prefektit, vetëm për këtë çështje u realizuan 6 takime sensibilizuese me strukturat vendore të bashkive respektive të qarkut, takime me anëtarët e task forcës, drejtues të institucioneve në nivel vendor duke realizuar nje harmonizim dhe bashkëpunim të të gjithë aktorëve.

Rezultatet si më poshtë, i dedikohen strukturave të DVP.

Rezultate të luftës kundër kultivimit të kanabisit për vitin 2024

Gjatë vitit 2024 janë evidentuar 46 raste të kultivimit të kanabisit, janë evidentuar dhe asgjësuar 15.256 bimë narkotike, janë implikuar 40 autorë, nga të cilët, janë arrestuar 25, shpallur në kërkim 11 dhe ndiqen në gjendje të lirë 4 autorë. Janë kryer gjithsej 12.885 kontrolle.

Janë kontrolluar 242 sera, 2.377 ambiente të mbyllura (magazine/objekte, ish objekte ushtarake, shtëpi të braktisura, stane/stalla, dhe 10266 ambiente të hapura.

Nr	Antikanabis	Viti 2023	Viti 2024	Krahasimi
1	Vepra penale për kultivim	153	46	-107
2	Procedime proaktive kultivimi	12	9	- 3
3	Raste kultivimi të evidentuara	153	46	-107
4	Raste kultivimi zbuluar	35	24	- 11
6	Bimë të asgjësuar	61239	15256	- 45983
7	Fidanë / kubikë të asgjësuar	6508	5908	- 604
8	Vende kultivimi	364	100	- 264
9	Proceduar autorë për kultivim	46	40	- 7
10	Autorë të arrestuar/ndaluar	13	25	+ 12
11	Proceduar kryeplak, inspector pyjor	21	29	+ 8
12	Numri i kontrolleve në territori total	4144	12885	+ 8741
13	Sera të kontrolluara	236	242	- 6
14	Ambiente të hapura	2644	10266	+ 722

I rendësishëm është fakti se gjatë vitit 2024 për kontrollin e territorit, organet e vetëqeverisjes vendore kanë qenë më bashkëpunuese me policinë e shtetit.

Janë hartuar rregullisht raporte javore dhe mujore për sigurinë dhe rendin, kanabisin për raportim çdo të enjte në ZOS dhe Ministrinë e Brendshme.

Bazuar në urdhërin nr. 6 datë 26.01.2017 të Kryeministrit “Për ngritjen e Komiteteve rajonale dhe tryezave teknike antitrafik”, me urdhërin nr. 7 datë 24.01.2020 të prefektit, kanë funksionuar normalisht sipas rregullores **KRAT, TT** dhe nënkomitetet Kurbin dhe Mirditë, duke realizuar

planin e veprimit të vitit 2024 të miratuara në mbledhjen e përbashkët të KRAT dhe TT date 24.02.2024.

Tryeza Teknike Antitrafik ka ndjekur rregullisht rastet e evidentuara të trafikimit dhe atyre të mundshme për trafikim duke bërë me përgjegjësi dhe profesionalizëm monitorimin e tyre duke u angazhuar fuqishëm për rehabilitimin e rasteve. Tryeza teknike është mbledhur rregullisht çdo 2 muaj për të analizuar rastet e identifikuar dhe ka raportuar çdo 3 muaj pranë KRAT dhe Koordinatorit kombëtar. Gjatë gjithë vitit anëtarët e TT kanë zhvilluar aktivitete sensibilizuese dhe ndërjegjësuere me target grupe të ndryshme në funksion të parandalimit të rasteve, identifikimit të viktimave/ viktimave të mundshme të trafikimit dhe rehabilitimit të tyre. Kulmin e tyre aktivitetet e arritën në muajin tetor, tashmë i shpallur si muaji antitrafik gjatë të cilave u vu re fryma e lartë e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit nderinstitucional në mbarëvajtjen e aktiviteteve, për të cilat iu raportua edhe KRAT- it dhe Koordinatorit Kombëtar Antitrafik.

Gjatë vitit 2024 nuk janë evidentuar dhe identifikuar raste të viktimave të trafikimit, apo të mundshme për trafikim, por janë mbajtur nën monitorim rastet e viktimave të mundshme të vlerësuara më parë.

Bazuar në Urdhrin nr. 185 datë 31.10.2023 të Kryeministrit, “Për ngritjen dhe funksionimin e Komiteteve Rajonale për Parandalimin e Radikalizimit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm”, VKM nr.81 datë 14.02.2023 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftës kundër terrorizmit 2023 - 2025 dhe planeve të veprimit 2023 – 2025”, me Urdhrin nr. 01 datë 04.01.2024 të Prefektit, është ngritur dhe ka funksionuar **Komiteti Rajonal për Parandalimin e Radikalizimit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm**” (KREDH) në qarkun Lezhë.

Për vitin 2024, nga anëtarët e KREDH nuk është raportuar ndonjë rast i identifikuar për shfaqje të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në qarkun Lezhë.

Është hartuar dhe dërguar një raport mbi zbatimin e planit të veprimit për parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, për periudhën 9 mujore.

Është pritur dhe mbetemi në pritje të trajnimeve të premtuara nga qendra për mirëfunksionimin e kësaj strukture.

Në zbatim të VKM nr.678, datë 30.10.2024 “Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të këshillave vendor të sigurisë publike dhe këshillit kombëtar për sigurinë në komunitet”, pika 2, u është kërkuar 3 bashkive të qarkut ngritja e **këshillave vendorë të sigurisë publike**, ku rezulton se nga 3 bashkitë është ngritur e funksion KVSP.

Arsimi

Një vëmendje të veçantë kemi patur në monitorimin e sektorit të arsimit, si sektor që qeveria po i jep gjithnjë e më shumë rëndësi. Gjatë vitit 2024 Institucionet e Arsimit Parauniversitar të qarkut janë frekuentuar nga 14766 nxënës gjithsej, prej të cilëve 54.8 % në Lezhë, 32.9 % në Kurbin dhe 12.3% në Mirditë. Krahasuar me vitin 2023, vërehet ulje e numrit të nxënësve me 7.6 %, ku ndikim ka kryesisht emigrimi.

Mësimi është zhvilluar në 81 shkolla prej të cilave 75 janë shkolla publike dhe 6 janë shkolla jopublike. Për vitin shkollor 2024- 2025 ka 3 shkolla të mbyllura përkatësisht 1 në Lezhë, 1 në

Kurbin e 1 në Mirditë. Në të gjitha shkollat mësimi zhvillohet me një turn. Në disa shkolla të qarkut raportohet se ka problematika me ngrohjen për funksionim jo të mirë të kaldajave, ndërsa në shkollat e tjera bashkitë kanë marrë masa për mirëfunksionimin e sistemit të ngrohjes.

Paketa e Sigurisë në Shkolla.

Në kuadër të masave për garantimin e sigurisë në shkolla, që në shtator 2023, është ngritur dhe funksionon Task Forca Vendore për Garantimin e Sigurisë në Shkolla. Institucionet vendore, anëtarë të Task Forcës kanë raportuar periodikisht pranë Prefektit. Po ashtu nga ana jonë është raportuar mbi këtë tematikë në mënyrë të vazhdueshme pranë Ministrisë së Brendshme dhe Kryeministrisë. Ndërmjet anëtarëve të task Forcës ka patur bashkëpunim të mirë për zbatimin efikas të planit të masave të miratuar.

Në qarkun Lezhë për vitin shkollor 2024-2025 në pjesën më të madhe të institucioneve arsimore, nga Drejtoria Vendore e Policisë (DVP) në bashkëpunim me bashkitë *është përcaktuar perimetri i sigurisë në shkolla.*

Falë prezencës dhe kontroleve ditore së policisë së shtetit dhe policisë bashkiake në perimetrin e sigurisë, për këtë vit shkollor *nuk janë regjistruar incidente apo ndaluar nxënës ose persona të jashtëm*, krahasuar me disa raste të vitit të kaluar.

Në 9 shkolla të mesme të qarkut ka oficerë sigurie (OS): përkatësisht në Lezhë 4 OS, në Kurbin 4 OS dhe në Mirditë 1 OS. Është bërë shpallja dhe pritjet plotësimi i vakancave edhe për 5 oficerë sigurie shtesë në disa shkolla 9 vjeçare e të mesme të bashkisë Lezhë.

Gjatë vitit shkollor ka vazhduar zbatimin e Programit të Përbashkët në mes DVP Lezhë dhe Zyrave Vendore të Arsimit (ZVAP-të) ku janë zhvilluar takime dhe disa fushata ndërgjegjëse me temë “Siguria e të Rinjve”, “Stop Dhunës dhe Trafikimit”, “Stop Bullizimit Kibernetik”, etj. Bashkitë e qarkut kanë vendosur e mirëmbajtur sinjalistikën rrugore horizontale dhe vertikale pranë shkollave në zonat urbane.

Institucionet arsimore në zonat urbane janë të pajisura me *kamera sigurie.*

ZVAP-të kanë siguruar që *mjetet për transportin e nxënësve të kenë logot dhe shenjat përkatëse* në mënyrë të unifikuar, dhe të qarkullojnë në kushte të larta sigurie teknike.

Nga AKU Lezhë informohemi se për periudhën Shtator-Tetor-Nëntor 2024 janë

kryer 41 inspektime jashtë plani në subjekte që ushtrojnë veprimtarinë e tyre pranë apo brenda shkollave, krahas atyre të planifikuara me baze rrisht.

Po ashtu janë zhvilluar monitorime në shkolla nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) për zbatimin e normave higjieno-sanitare në të gjitha institucionet arsimore parauniversitare. Në rastet kur nga ISHSH nuk është dhënë leja higjieno-sanitare e objektit, ZVAP-të kanë bërë kërkesa pranë bashkive për përmbushje të kushteve higjieno-sanitare.

Sa i përket IKMT Lezhë, lidhur me kontrollin e perimetrit të sigurisë, gjatë vitit 2024 ka zhvilluar 20 inspektime në shkollat e qarkut Lezhë.

Siguria ushqimore dhe transumanca

Me datën 26.02.2024 Prefekti organizoi një takim me aktorët kryesorë në fushën e *sigurisë ushqimore dhe transumancës*, duke evidentuar situatën aktuale dhe duke raportuar mbi këtë pranë Ministrisë së Brendshme.

Me porosi të institucioneve qendrore janë grumbulluar, përpunuar e raportuar të dhënat mbi: tematikën e emisionit të pullave zyrtarë për vitin 2026; evidencën e të dhënave për pyjet; sigurinë ushqimore; mbi zbatimin e sistemit e-gjopa në bashkitë e vendit; statistika vjetore lidhur me turizmin, paketën e sigurisë, kanabisin, etj.

Është ndjekur e raportuar pranë MB, dhënia e mendimeve nga anëtarët e KRAT dhe TT lidhur me draft-urdhrin e Kryeministrit mbi funksionimin e këtyre organizmave.

Është bërë dhënie mendimi pranë MB, mbi draft-plan veprimin për sigurinë në komunitet.

Me urdhër të Prefektit, specialistë të SMKVFDD kryejnë shërbimin e *legalizimit të dokumentave* për jashtë vendit, ku për 2024 janë legalizuar 681 dokumenta.

Specialistët e sektorit të monitorimit të kompetencave vendore dhe funksioneve të deleguara kanë hartuar planet dhe programet e punës sipas problematikave që mbulojnë dhe janë përgatitur për të realizuar me sukses detyrat e përcaktuara.

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2025

1. Të rritet niveli i bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore, policinë e shtetit, institucionet qendrore në nivel vendor për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike.
2. Bashkëpunim më i mirë me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet qendrore në nivel vendor, organizma, organizata e shoqata që operojnë në territorin e qarkut, për realizimin e detyrave të përcaktuara lidhur me luftën kundër trafikimit të personave.
3. Bashkëpunim më i ngushtë me strukturat, anëtare të Task-Forcës Vendore për luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, për rritjen e efikasitetit të tyre në kontrollin dhe monitorimin e territorit.
4. Mbajtja e kontakteve të vazhdueshme me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe institucionet rajonale/vendore, monitorim i veprimtarisë së tyre, me qëllim funksionimin optimal të Task Forcave, Komiteteve Rajonale, Tryezave Teknike , grupeve të punës të ngritura nga Prefekti, forcimit të bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional, raportimin në kohë pranë institucioneve qendrore, për përmbushjen me sukses të misionit të Prefektit në qark.
5. Zgjerimi i bashkëpunimit me Institucionet qendrore, vendore, por edhe brenda vetë organizatës (sektorëve këtu).
6. Punë e vazhdueshme për ngritjen personale e profesionale të SMKVFDD, duke u përditësuar me legjislacionin, duke marrë pjesë në aktivitete, trajnime etj për një figurë sa më dinjitoze si nëpunës civil e shtetas.

2- SEKTORI JURIDIK

Kjo analizë pasqyron punën e Sektorit Juridik për periudhën 1 Janar 2024 - 31 Dhjetor 2024. Sektori Juridik e ushtron veprimtarinë mbështetur në ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, urdhërin e Kryeministrit nr.50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", Urdhërin e Ministrit të Brendshëm nr.175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", Urdhërin e Prefektit të Qarkut Lezhë nr.47, datë 05.08.2020 "Për miratimin e rregullores së Administratës së Prefektit të Qarkut Lezhë".

Gjatë vitit 2024 nga Sektori Juridik janë marrë të gjitha masat në lidhje me zbatimin e kërkesave të ligjit, zbatimin e detyrave të Prefektit të Qarkut, ndjekja e zbatueshmërisë së ligjit në vendimarrje nga ana e njësisve të qeverisjes vendore, ndjekjen e proceseve gjyqësore në të cilët Prefekti i Qarkut është palë, trajtimin e procedurave në lidhje me dhënien e masës plotësuese mbi pezullimin e lejeve të drejtimit të lëshuar nga një shtet i huaj, trajtimin dhe ndjekjen e ankesave të shtetasve deri në zgjidhjene tyre, zhvillimin e procedurës së prokurimeve me vlerë të vogël për nevojë të institucionit, azhurnimin e administratës me ndryshimet e bazës ligjore, dhënien e konsulencës juridike etj.

Detyrat primare të këtij Sektori për vitin 2024 kanë qënë:

- Zbatimi me përpikmëri i ligjit në të gjitha fazat dhe procedurat e tij.
- Shprehja për ligjshmërinë e vendimeve të marra nga njesitë e qeverisjes vendore.
- Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve normative në njesitë e vetëqeverisjes vendore.
- Ndjekja e të gjitha çështjeve gjyqësore në të tre shkallët e gjykimit.
- Koordinimi i punës ndermjet sektorëve me qëllim që e gjithë veprimtaria e administratës së Prefektit të Qarkut Lezhë të behet në përputhje me procedurat ligjore. Për këtë qëllim sektori juridik ka dhënë asistencën e nevojshme ligjore për çdo sektor.
- Trajtimin në kohë dhe sipas procedurave të caktuara të lejedrejtiveve të lëshuara nga një shtet i huaj.
- Zhvillimin e procedurës së prokurimeve me vlerë të vogël për nevojë të institucionit.
- Zgjidhja e problemeve të qytetarëve.

-Gjatë vitit 2024 Sektori Juridik ka realizuar konkretisht detyrat si më poshtë :

PROCESET GJYQËSORE

- A. Gjatë këtij viti Sektori Juridik ka paraqitur pranë Gjykatës së Lartë disa kërkesa për kalim procedural të palëve referuar nenit 199 të Kodit të Pr.Civile, për rastet kur pala paditëse ka qënë i punësuar si zjarrfikës duke qënë se ky shërbim ka kaluar pranë bashkive dhe konkretisht:

1. Çështja gjyqësore me palë;

Paditës: Fran Tusha

I Paditur: Prefektura e Qarkut Lezhë

Objekti: Konstatimin e pavlefshmërisë së zgjidhjes së kontratës së punës nga i padituri dhe kthimin e paleve në gjendjen e mëparshme. Anullimin e urdherit nr.15, dt.18/02/2014 "Për lirim nga detyra" për paditesin. Pezullimin e zbatimit të këtij urdheri deri në gjykimin përfundimtar të kërkesë padisë etj.

Pas kërkesës për kalim proceduaral nga ana jonë çështja vazhdon të jetë në proces te Gjykata e Lartë.

2. Çështja gjyqësore me palë;

Paditës: Arben Doda , i biri i Gjinit dhe i Dilës, i datëlindjes 06.02.1970, lindur në Velë, Lezhë banues në Lezhë.

I Paditur: Prefekti i Qarkut Lezhë

Objekti: Detyrimin e pales se paditur Prefekti i Qarkut Lezhë, pasi punëdhënesi ka bërë zgjidhjen e kontratës së punës pa afat të caktuar në mënyrë të menjherëshme pa shkaqe të justifikura, të justifikuara dhe si e tillë në bazë të nenit 155 të Kodit të Punës detyrohet të paguaj demshperblim 1 vit pagën bruto paditesit etj.

Në lidhje me këtë proces gjyqësor ne kemi kërkuar kalim proceduaral të palëve referuar nenit 199 të Kodit të Pr.Civile, në Gjykatën e Lartë, e cila ka vendosur me datë 23.4.2024 lënien në fuqi të vendimit nr.1041, datë 15.3.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë duke refuzuar dhe kërkesën për kalim proceduarial të palëve.

3. Çështja gjyqësore me palë;

Paditës: Pal Marku

I paditur: Prefekti i Qarkut Lezhë

Objekti : Shfuqizim tërësisht të aktit administrativ urdhërit nr.45, datë 16.12.2015“Për lirim nga detyra të luftuesit në stacionin e PMNZSH-së Lezhë

Me datë 25.03.2024 institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë është njohur me dëftesën e komunikimit datë 20.03.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për çështjen me nr.rregjistrimi 5041/4571-06808 datë 11.09.2023 me palë paditëse Pal Marku dhe palë të paditur : Prefektura e Qarkut Lezhë.

Pala e paditur , Prefekti i Qarkut Lezhë i është drejtuar me kërkesë për kalim proceduarial të palëve pasi jemi në kushtet që kërkon neni 199 i Kodit të Proedurës civile në të cilën parashikohet së :“ *Kur pala që është person juridik mbaron, çështja vazhdon nga ose kundër personit juridik a fizik, të cilit i kanë kaluar të drejtat e detyrimit e personit juridik që ka mbaruar*” Me shkresën nr 40/1 prot datë 16.01.2024 i kemi dërguar kërkesën për kalim proceduarial të

palëve nga palë e paditur Prefekti i Qarkut Lezhë në palë të paditur bashkia Lezhë e cila është bashki që i ka kaluar shërbimi zjarrfikës pjesë e të cilit ka qenë dhe pala paditëse. Për çështjen në fjalë nuk është pranuar kërkesa jonë për kalimin procedural nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë .Me vendimin nr.16, datë 16.5.2024. Gjykata ka vendosur pranimin e pjesëshëm të padisë së palës paditëse Pal Marku.Kundër këtij vendimi kemi bërë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

4. Çështja gjyqësore me palë;

Paditëse: Pjetër Nikolli

I Paditur: Prefekti i Qarkut Lezhë

Objekti: Aullim i aktit administrative i nxjerrë nga pala e paditur , urdhër nr.33, datë 27.02.2014

Konstatimi i përfundimit të marrëdhënieve të punës në mënyrë të menjëhershme të paarsyeshme dhe të pamotivuar ne prova dhe ne ligj, etj...

Pasi jemi njohur nga Gjykata e Lartë nëpërmjet e-mail-it zyrtar mbi procesin gjyqësor të mësipërm Prefekti i Qarkut Lezhë si palë e paditur ka dorëzuar me shkrim kërkesë për kalim procedural të palëve drejtuar Gjykatës së Lartë me datë 25.04.2024. Qështja në fjalë vazhdon të jetë në proces në Gjykatën e Lartë.

5. Çështja gjyqësore me palë;

Paditës: Aleksander Ndoj Kurbin

I Paditur: Prefekti i Qarkut Lezhë

Objekti: Demshperblimin me 12 muaj page per shkak te zgjidhjes se kontrates se punes ne menyre te menjehershme, pa shkaqe te arsyeshme, me 3 muaj page per mosrespektim te afatit te njoftimit te zgjidhjes se kontrates se punes etj;

Pasi jemi njohur nga Gjykata e Lartë nëpërmjet emailit zyrtar mbi procesin gjyqësor në fjalë Prefekti i Qarkut Lezhë si palë e paditur kemi dorëzuar me shkrim kërkesë për kalim procedural të palëve drejtuar Gjykatës së Lartë me datë 28.05.2024. Gjykata e Lartë me datë 11.06.2024 ka vendosur: Prishjen e vendimit nr. 168 (104), datë 25.01.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 41, datë 21.01.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër e cila me vendimin nr. 41, datë 21.01.2015 ka vendosur: “Pranimin e pjesëshëm të padisë; Detyrimin e palës së paditur, Prefektura e Qarkut Lezhë, t’i paguajë paditësit Aleksandër Ndoj si dëmshpërblim pagën e 10 (dhjetë) muajve, për shkak të lirimit të paligjshëm nga PMNZSH- Lezhë; Detyrimin e palës së paditur, Prefektura e Qarkut Lezhë, të trajtojë financiarisht paditësin Aleksandër Ndoj sipas nenit 12 i ligjit nr. 10 142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht me dy paga referuese të menjëhershme dhe pagesën kalimtare sipas ligjit; Rrëzimin për pjesën tjetër të kërkit. Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe do të ekzekutohet menjëherë, pasi vendimi të ketë marrë formë të prerë. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur (në masën 3.000 lekë, taksa e

regjistrimit të kërkesë padisë). Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, nga e nesërmja e shpalljes së vendimit. Ky vendim është ekzekutuar nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë.

B. *Jemi njohur nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë mbi procesin gjyqësor me;*

PADITËS: Alfrida Marku , përfaqësuese e Partisë Demokratike në Këshillin e Bashkisë Lezhë .

I PADITUR: Këshilli i bashkisë Lezhë ; Adresa Lezhë

Prefekti i Qarkut Lezhë

OBJEKTI : -Sigurimin e padisë , duke bërë pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.64, datë 31.10.2023 të Këshillit të Bashkisë Lezhë.

-Shfuqizimin e vendimit nr. 64 datë, datë 31.10.2023 të këshillit të bashkisë Lezhë që ka miratuar project-vendimin e dërguar me shkresën nr.16291prot, datë 25.10.2023 të Kryetarit të Bashkisë Lezhë “Për Miratimin e nivelit të taksave , tarifave vendore për shërbimet publike , strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundravajtësve”dhe kthimin për rishqyrtim në Këshillin e bashkisë Lezhë.

Si pale e paditur kemi dorëzuar me shkrim pranë Gjykatës Adm.Tiranë prapësimet për këtë kërkesë padi dhe kemi kërkuar rrezimin e saj si të pambeshtetur në prova dhe në ligj.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me datë 04 dhjetor 2024, vendosi në prani të palëve të rrëzojë kërkesë padinë e ngritur nga pala paditëse.

C. *Mbi procesin gjyqësor me palë;*

Paditës: Xhemal Haxhia

Palë e paditur: Prefekti i Qarkut Lezhë.

Objekti: Dëmshpërblim për zgjidhje të menjëhershme të kontratës individuale të punës. Gjykata ka vendosur pranimin e plotë të padisë. Jemi duke pregaditur ankimin për në Gjykatë të Apelit Tiranë

Me datë 04.04.2024 jemi vene ne dijeni nga Gjykata e Apelit Tirane për caktimine seances gjyqësore me datë 24.05.2024 me pale paditëse Xhemal Haxhia dhe pale e paditur Prefekti I Qarkut Lezhe. Me datë 08.04.2024 kemi derguar prapësimet me shkrim për çështjen në fjalë.

Gjykata administrative e shkallës së Parë Tiranë me datë 22.05.2024 ka vendosur pranimin e plotë të kërkesë Padisë.

Me datë 30.07.2024 jemi vënë në dijeni nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 1797 datë 22.05.2024 me palë paditëse XH.H objekt: Dëmshpërblim për zgjidhje të menjëhershme të kontratës individuale të punës. Gjykata ka vendosur pranimin e

plotë të padisë. Kemi dorëzuar ankimin nr.628/1 prot, date 01.08.2024 në Gjykatën e Apelit Tiranë.

D. Mbi procesin gjyqësor me palë;

Paditës:Prefekti i Qarkut Lezhë

I paditur: Pëllumb Tollia

Me datë 10.06.2024 nga Gjykata e Apelit Administrativ na është vënë në dispozicion vendimin nr. 976 , datë 30.05.2024 me nr. akti 16703 me palë paditese Prefekti i Qarkut Lezhë dhe palë të paditur Pëllumb Tollia. Gjykata Administrative e Apelit ka lënë në fuqi vendimin nr 531 datë 20.07.2017 të Gjykatës administrative të Shkallës së Parë Shodër e cila ka vendosur : detyeimin palës së paditur P.T të shpërbleje demin e shkaktuar në vlerën 2 052 057 lekë.

Me datë 12.08.2024 nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tirane na është vënë në dispozicion vendimi nr.531, datë 20.07.2017 i formës se prerë me palë te paditur Pëllumb Tollia. Ky vendim është dërguar për ekzekutim pranë Zyrës Përmbartimore Lezhë me datë 13.08.2024. Me datë 16.08.2024 jemi vënë në dijeni nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë mbi vendimin e pushimit të procedimit penal me kallëzues Pëllumb Tollia.(Vendim nr.53- 2024-2328)

Zyra përmbartimore Lezhë ka refuzuar ekzekutimin e vendimit të mësipërm. Me datë 09.09.2024 kemi ngritur padi ndaj Zyrës përmbartimore Lezhë duke kërkuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë Kundershtim i veprimeve përmbartimore . Kundershtim të shkresës nr. 432/2 prot , datë 02.09.2024 “ Kthim përgjigje”, “Detyrimin e palës së paditur Zyra Përmbartimore Lezhë që të bëjë ekzekutimin e Vendimit nr.531(633) datë 20.07.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Shkodër lënë në fuqi me Vendimin nr.976, datë 30.05.2024 nga Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë me vendimin nr.2757-787 datë 24.09.2024 ka shpallur moskompetencen dhe ka vendosur dergimin e akteve pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka dalë me vendim nr.4106 (80-2024-4200), datë 12.11.2024, i cili e ka rrëzuar kërkesë padinë e bërë nga ana jonë.

Pas marrjes ne dujeni të vendimit të arsyetuar institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë brenda afatit 5-së ditor të ankimit ka paraqitur ankimin në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

E. Gjatë këtij viti Sektori Juridik ka patur edhe një proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë që u përket palëve:

Paditës: Fred Syziu

I Paditur: , Ndërmarrja e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë

Person i tretë: Inspektoriati i mbrojtjes së Territorit

Bashkia Kurbin

Prefekti i Qarkut Lezhë

Objekti: Pagim dëmi

Për çështjen administrative të mësipërme sektori juridik ka paraqitur prapësimet përkatëse sipas objektit të padisë ku kemi kërkuar moslegjitimimin si person i tretë e në vijimësi kur Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë na ka thirrur si palë e paditur institucioni Prefektit të Qarkut Lezhë nëpërmjet sektorit juridik ka dërguar prapësimet për tu përjashtuar si palë e paditur.

Ky proces gjyqësor vijon në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

VENDIMET E NJESIVE TË QEVERISJES VENDORE DHE TRAJTIMI I TYRE

Gjatë vitit 2024, në Sektorin Juridik janë depozituar **232 vendime të njesive të qeverisjes vendore**, ku janë **konfirmuar për bazueshmërinë ligjore 221 vendime, 7 janë kthyer me shkresë si akte individuale , 4 vendime të kthyer për rishqyrtim** 2 të këshillit të qarkut Lezhë, 1 të këshillit të bashkisë Lezhë, 1 të Këshillit të bashkisë Mirditë. Nuk kemi patur raste të dërgimit në gjykatë të aktit për pavlefshmëri. Gjate vitit 2024, krahasuar me vitin 2023, kemi trajtuar 87 vendime me pak.

<u>Viti</u>	<u>Vendime gjithësej</u>	<u>Vend. të konfirmuara</u>	<u>Vend.të kthyer për rishqyrtim</u>	<u>Vendime të kthyer si individuale</u>
<u>2023</u>	<u>319</u>	<u>318</u>	<u>1</u>	<u>0</u>
<u>2024</u>	<u>232</u>	<u>221</u>	<u>4</u>	<u>7</u>

- **Të cilat më konkretisht për vitin 2024 janë si më poshtë siç vijon:**

-Për muajin Janar janë depozituar **23 vendime**, të gjitha të konfirmuara nga ana jonë;
-Për muajin Shkurt janë depozituar **37 vendime**, të gjitha të konfirmuara nga ana jonë;
-Për muajin Mars janë depozituar **23 vendime**, të gjitha të konfirmuara nga ana jonë;
-Për muajin Prill janë depozituar **14 vendime**, 13 prej të cilëve janë konfirmuar një është kthyer për rishqyrtim për paligjshmëri;
-Për muajin Maj janë depozituar **20 vendime**, të gjitha të konfirmuara nga ana jonë;
-Për muajin Qershor janë depozituar **16 vendime**, 15 prej të cilëve janë konfirmuar 1 akt është kthyer me shkresë si akt individual;
-Për muajin Korrik janë depozituar **19 vendime**, të gjitha të konfirmuara nga ana jonë;
-Për muajin Gusht janë depozituar **18 vendime**, 17 prej të cilëve janë konfirmuar 1 është kthyer për rishqyrtim për paligjshmëri
-Për muajin Shtator janë depozituar **13 vendime**, 10 prej të cilëve janë konfirmuar dhe 3 janë kthyer me shkresë si akte individuale;
-Për muajin Tetor janë depozituar **24 vendime**, 21 prej të cilëve janë konfirmuar dhe 3 janë kthyer me shkresë si akte individuale;
-Për muajin Nëntor janë depozituar **6 vendime**, të gjitha të konfirmuara nga ana jonë;
-Për muajin Dhjetor janë depozituar **19 vendime**, 17 prej të cilëve janë konfirmuar dhe 2 janë kthyer për rishqyrtim për paligjshmëri.

VERIFIKIMI NË VEND I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE

-Gjatë këtij viti (në 9 muajorin e parë), në zbatim të Ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar sipas nenit 17, pika 1, është bërë verifikimi në vend të akteve me karakter normativ, është kryer verifikimi në vend të ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të këshillit të bashkisë Lezhë, të këshillit të bashkisë Mirditë, të këshillit të bashkisë Kurbin si dhe në këshillin e qarkut Lezhë për tre herë rrallazi sipas procedurës së parashikuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, sipas nenit 17, pika 1.

Periudha e verifikimit në vend të ligjshmërisë së akteve me karakter normativ në të treja bashkitë, është 1 Janar 2024 – 30 Shtator 2023, ndërsa për tre mujorin e fundit të vitit 2023 do të zhvillohet në janar të vitit 2024.

Nga verifikimi në vend i akteve me natyrë normative, mbi bazen e procesverbaleve të mbajtura, në të tre bashkitë e qarkut Lezhë (**Lezhë, Kurbin, Mirditë si dhe në Këshillin Qarkut Lezhë**), bazuar në ligjin nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 16 dhe neni 17 pika 1, grupi i punës, **nuk konstatoi asnjë akt normativ të padepozituar për verifikim ligjshmërie në institucionin e prefektit të Qarkut Lezhë**, në asnjërin nga këshillat bashkiak të verifikuar. Në fund nga grupi i punës u realizua për secilin verifikim një raport mbi gjetjet nga verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve.

Për 9-të mujorin e vitit i 2024 (Janar –Shtator) është kryer verifikimi në vend për 273 akte të Njesive të Verqeverisjes Vendore. Periudha Tetor-Nëntor 2024 verifikohet gjatë muajit Janar 2024 ndërsa muaji dhjetor do verifikohet në muajin mars 2025.

TRAJTIMI I KORRESPONDENCËS ME INSTITUCIONET DHE TË TRETËT

- *Gjatë vitit 2024 kemi trajtuar gjithsej 72 shkresa të ardhura nga organe dhe shtetas të ndryshëm të cilëve u kemi kthyer përgjigje brenda afateve ligjore duke bashkëpunuar me organet përkatëse për zgjidhjen e tyre.*

Muaji	Nr.Shkresave	Institucione
Janar	7	Te ndryshme
Shkurt	7	
Mars	3	
Prill	2	
Maj	7	
Qeshor	10	
Korrik	8	
Gusht	5	
Shtator	7	
Tetor	4	
Nentor	6	
Dhjetor	6	
Gjithej total	72 shkresa	

LEJET E DREJTIMIT

Referuar Udhëzimit të Ministrit të Punëve të nr.155, datë 05.08.2022 “Për procedurat e evidentimit dhe shqyrtimit të kundravajtjeve administrative dhe pasqyrat statistikore në fushën e qarkullimit rrugor”, Kreu 4, pika 1, germa “a“, i ndyshuar, **gjatë vitit 2024 nga Sektori Juridik janë trajtuar me vendim gjithsej 182 lejedrejtimi**, për të cilat jemi shprehur për pezullim e të gjithave sipas shkeljes së kryer bazuar në kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë. Gjatë vitit 2024 krahasuar me vitin 2023 kemi trajtuar 15 leje drejtimi të huaja me pak.

Viti	Nr.patentave te trajtuara	Mospezullim	Pezullim
2023	197	11	186
2024	182	0	182

PROCEDURAT E BLERJEVE ME VLERË TË VOGËL TË ZHVILLUARA GJATË VITIT 2024

Gjatë vitit 2024 janë kryer gjithsej 2 (dy) procedura prokurimi blerje me vlerë të vogël me objekt:

1. Sigurim ndërtese
2. Blerje karburanti

OBJEKTIVA TË SEKTORIT JURIDIK PËR VITIN 2025

Objektivat që synojmë të përmbushim me sukses për vitin 2025 janë si më poshtë:

1. Rritja e performancës në zbatimin e ligjit nga institucioni i Prefektit dhe përcjellja e frymës ligjzbatuese edhe te institucionet e tjera në nivel qarku. Qëllimi i përgjithshëm i sektorit juridik është mbështetja ligjore e gjithë veprimtarisë dhe aktivitetit të Prefektit, në përputhje me ligjet në fuqi .
2. Forcimi i rolit të Prefektit të Qarkut në marrëdhënie me Njësitë e Veteqeverisjes Vendore, gjatë verifikimit të ligjshmërisë së akteve normative me qëllim rritjen e standartit ligjor të vendimarrjes nga ana e këtyre njësive si dhe përmbushja nga ana e NJVQV-ve e rekomandimeve të lëna nga grupi i punës, gjatë procesit të verifikimit në vend.
3. Të marrë pjesë në çdo nismë apo iniciativë për propozime për ndryshime të kuadrit ligjor në fuqi duke patur parasysh që çdo ndryshim në aktet nënligjore dhe në legjislacion duhet të jetë në përputhje me parimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në harmoni me qasjen e BE-së
4. Të bashkërendojë, nëpërmjet institucionit të Prefektit, veprimtarinë e institucioneve qendrore në nivel vendor dhe funksionet e deleguara të tyre, me njësitë e qeverisjes vendore në bashki e qarqe.
5. Harmonizimi dhe bashkëpunimi i punës ndërmjet sektorit juridik të Prefektit të Qarkut Lezhë dhe strukturave të policisë së Shtetit (policisë rrugore) mbi sensibilizimin nga ana e punonjesve të policisë të shkelësve të rregullave të qarkullimit rrugor mbi efektet e masës plotesuese të pezullimit të lejeve të drejtimit të leshuar nga një shtet i huaj .
6. Pjesëmarrje dhe angazhim maksimal në trajnimet profesionale që ofron ASPA, më qëllim rritjen e nivelit profesional të çdo nëpunësi civil.

3-SEKTORI I FINANCES DHE SHERBIMEVE MBESHTETESE

Gjatë vitit 2024, si rezultat i rritjes së nivelit të bashkëpunimit dhe koordinimit të punës, mes sektorëve dhe institucioneve qëndrore në nivel vendor dhe organeve të vetëqeverisjes vendore është përmirësuar performanca e Institucionit të Prefektit.

Arritjet në realizimin e detyrave dhe prioriteteve, në përputhje me programin e qeverisë janë rezultat i rritjes së profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë së administratës publike.

Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse për vitin 2024 ka ndjekur dhe realizuar këto detyra:

- Është hartuar buxheti vjetor dhe afatmesem për Institucionin e Prefektit.
- Është bërë rakordimi periodik mujor dhe progresiv me degën e Thesarit.
- Është bërë kontabilizimi i veprimeve financiare në ditaret perkates.
- Janë përgatitur evidencat mujore dhe progresive çdo muaj për shpenzimet e institucionit të Prefektit dhe janë dërguar në afat në Ministrinë e Brendshme.
- Është mbyllur llogaria vjetore (bilanci kontabël) për vitin 2023, kjo në zbatim të Udhëzimit të MF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
- Është bërë inventarizimi i aktiveve të Institucionit të Prefektit për vitin 2024, kjo në zbatim të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.
- Janë përgatitur listë-pagesat për pagat dhe sigurimet shoqërore, mujore, rregullisht dhe janë hedhur në sistemin e tatimeve ku është bërë dhe rakordimi përkatës mujor dhe progresiv.
- Është ndjekur zbatimi i kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe aktet ligjore e nënligjore në zbatim të tij..
- Në zbatim të Urdhërit të Prefektit kemi qënë pjesë e komisionit të diskutimit dhe miratimit të buxheteve për njësitë e vetqeverisjes vendore, ku është dhënë konsulenca në lidhje me planifikimin dhe detajimin e buxhetit vendor.
- Nga sektori i Financës gjatë vitit **2024** janë trajtuar dhe dhënë përgjigje brenda afatit kohor gjithsej **337** shkresa, kto të protokolluara. Ndërsa kërkesat që na janë drejtuar me e-mail kanë kërkuar dhe përgjigja është dhënë po me e-mail, kjo sipas kërkesës së tyre. Kjo praktike ka qënë me MB, DAP-in, ILDKPKI dhe Komisionerin për Mbikqyerjen e Shërbimit Civil.
- Në bashkëpunim me përgjegjësat e sektorëve është përgatitur dhe ndjekur rregjistri i rriskut.

FINANCA

Në zbatim të legjislacionit në fuqi Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë, ka zbatuar dhe ndjekur realizimin e buxhetit sipas strukturave buxhetore, zërave të shpenzimeve, në artikuj dhe nënartikuj buxhetore, kjo sipas planit të buxhetit.

Buxheti i ardhur nga Ministria e Brendshme është detajuar në zëra e nënzëra shpenzimesh e ndarë në periudha mujore.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2024, shpenzimet në total dhe sipas zërave paraqiten si më poshtë:

Llogaria ekonomike	E m e r t i m i	Plani vjetor me ndryshimet + / -	Realizimi	Diferenca + / - ne 000/leke	Realizimi në %
<u>Aparati i Prefektit 01 160 1</u>					
600	Paga	30,883	28,453	- 2,430	92.1 %
601	Sigurime shoqërore	5,103	4,679	- 424	91.7 %
602	Shpenzime operative	7,635	6,283	- 1,352	82.3 %
606	Shpenzime (shpërblime)	300	200	-100	66.7 %
231	Investime gjithësej	0	0	0	0%
	Shuma	43,921	39,615	- 4,306	90.2 %
<u>Arkiv Gj. Civile 01 170 1</u>					
600	Paga	4,000	3,898	-102	97.5 %
601	Sigurime shoqërore	668	651	-17	97.5 %
602	Shpenzime operative	11	11	0	100 %
	Shuma	4,679	4,560	-119	97.5 %
<u>Total Institucioni 10 16 070</u>		48,600	44.175	4,425	90.9 %

Siç shihet nga të dhënat e mësipërme, shpenzimet në total u realizuan 90.9%, në shumën 44,175 mijë lekë, nga 48,600 mijë lekë të planifikuara, me një mosrealizim në vlerën 4,425 mijë lekë. Në zërin e pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mosrealizimi ka ardhur si rezultat i mosplotësimit të organikës për vendet vakante të krijuara, 3 vende vakante.

Në zërin “shpenzime operative” mosrealizimi ka ardhur si rezultat i diferencës nga procedurat e prokurimeve, pasi shuma e operatoreve kanë qënë pa tvsh, si dhe mosrealizimi i disa zerave të shpenzimeve të planifikuara por nuk janë realizuar. Në lidhje me mosrealizimin e këtyre zërave, është kërkuar me e-mail nga MB realizimi i parashikimit të pritshëm të buxhetit për vitin 2024 dhe dërgimi i fondeve të lira. Nga analiza e bërë e zërave të shpenzimeve ka rezultuar që për vitin 2024, fondet e papërdorura që rezultojnë të lira ishin në shumën 900 mijë lekë, gjë për të cilën i është kërkuar MB pakësimi për këtë shumë.

Gjatë vitit 2024 Administrata e Prefektit të Qarkut Lezhë ka pasur 4 vende vakante, ku 2 vende vakante janë mbyllur, përkatësisht; 1 pozicion, Përgjegjës në Sektorin e Zhvillimit Urban dhe 1 pozicion, Specialist në Sektorin e Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara.

Aktualisht janë 2 vende vakante dhe këto në kategorinë ekzekutive Specialist dhe në kategorinë e ulët drejtuese, Përgjegjës Sektori dhe konkretisht:

1. Specialist në sektorin Juridik, është shpallur nga DAP dhe është në proces.
2. Përgjegjës në sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse është shpallur nga DAP dhe është në proces.

Aktualisht janë në punë **25** punonjës në fakt nga **26** që është struktura sipas organikës në plan. Nga protokoll-arkiva është ndjekur praktika si, protokollimi i shkresave zyrtare, letrave te popullit dhe korespondenca e tyre. Pranimi i shkresave të përgatitura nga përgjegjësit e sektorëve, verifikimi i tyre për mënyrën e plotësimit sipas standarteve të përcaktuara nga ligji për arkivat, si dhe të urdhërit “Për njehsimin e dokumentit administrativ”. Sistemimi i dokumentacionit në dosje të shkresave të kthyera në arkiv, sipas sektorëve përkatës. Është sistemuar dhe dorëzuar në Arkiv dokumentacioni i vitit 2012. Vulosja e dokumentave për jashtë shteti të legalizuara nga Sektori Juridik dhe së fundmi nga Sektori Kompetencave Vendore.

Në drejtim të disiplinës së punës vërehet një përmirësim në zbatimin e kërkesave të VKM nr. 746, datë 04.12.2024 “Për disa ndryshime në VKM nr.568, datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompesimin e tyre në institucionet e administruara shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, është hartuar dhe ndjekur grafiku i lejeve vjetore të vitit 2024, i ndarë në periudha, ku pathuajse të gjithë punonjësit kanë kryer lejen vjetore për vitin 2024.

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2025

Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i mëtejshëm profesional i punonjësve të administratës, duke qenë faktor i rëndësishëm për të siguruar një menaxhim efektiv dhe të suksesshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, do të jetë një nga drejtimet kryesore të punës, duke e përqëndruar vëmendjen në;

- *Mbikqyrja e punës dhe veprimtarisë në realizimin e programit qeverisës, duke kërkuar nga institucionet qendrore në nivel vendor transparencë, përgjegjshmëri, komunikim dhe informim, llogaridhënie, ashpërsim të luftës ndaj fenomenit të korrupsionit, duke minimizuar në maksimum rrishtun.*
- *Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, si dhe ndjekja e zgjidhja e tyre.*

4- SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Gjatë vitit 2024, për realizimin e punës në Sektorin e Zhvillimit Urban jemi bazuar në planin e punës mujor e vjetor sipas Rregullores brendshme e detyrave të deleguara nga Titullari i Institucionit e konkretisht vlejshme të listohen:

- Bashkëpunimin në mënyrë të vazhdueshme me njësitë e vetëqeverisjes vendore për të siguruar një zhvillim urban në përputhje me politikat qeverisëse, me mbrojtjen e mjedisit dhe burimeve natyrore, me zhvillimet demografike, me kriteret dhe standartet e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore.
- Bashkërendimin e punës ndërmjet njësiteve të vetëqeverisjes vendore me institucionet qendrore në nivel vendor, me institucionet qendrore dhe me grupet e interesit, nëpërmjet

komiteteve, grupeve të punës, takimeve zyrtare, për zgjidhjen e problematikave të ndryshme në planifikimin e territorit dhe zhvillimit urban.

- Përpunimin e informacioneve të marra nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe drejtorive rajonale për të përgatitur informacione dhe raporte për Prefektin e Qarkut Lezhë.
- Ndjekja e zbatimit të urdhërave që nxjerr prefekti lidhur me ecurinë e zbatimit të ligjshmërisë në fushën e territorit dhe infrastrukturës, si dhe informimin e prefektit mbi ecurinë.
- Trajtimin dhe ndjekjen e ankesave të shtetasve deri në zgjidhjen e tyre.

Gjatë kesaj periudhe kohore janë kryer me efikasitet të gjitha shërbimet dhe zgjidhja e rasteve nga më të ndryshmet, të cilat në vetvete përfshinin aspekte dhe fusha nga më të ndryshmet si nga ana e planifikimit të territorit, por dhe ato në lidhje me aspektet mjedisore.

Për sektorin e Zhvillimit Urban në vitin 2024 ishte prioritet ndjekja çështjeve në lidhje me lejet e përdorimit të burimeve ujore nga Këshilli i Basenit Ujor Mat, si dhe e problematikave të shfaqura në mjedis dhe territor, duke bashkërenduar njësitë e vetëqeverisjes vendore, bashkinë Lezhë, bashkinë Kurbin, me institucionet qendore dhe degët territoriale në Qarkun Lezhë.

Më konkretisht gjatë vitit 2024 Sektori i Zhvillimit Urban është angazhuar në këto çështje:

BASHKËRENDIMI I PUNËS NDËRMJET INSTITUCIONEVE

Gjatë vitit 2024, çështje të ndryshme si:

Evidentimi dhe adresimi i problematikave të shfaqura në infrastrukturë dhe të argjaturës së lumit Mat, për të shmangur përmytjet gjatë reshjeve në periudhën e dimrit, tek institucione si bashkia Kurbin, IKMT dhe DBUK, në mënyrë që të arrihet një bashkëpunim ndërinstytucional për zgjidhjen e situatës; Gjithashtu është adresuar problem i përmytjeve të ndodhura në lagjen Xhenjo të bashkisë Lezhë, tek bashkia Lezhë dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar, si organet kompetente për trajtimin e rastit;

Ndjekja e çështjes së niveleve të ndotjes në zonën e hidrovorit Ishull-Shëngjin dhe në grykën e Merxhanit, duke u informuar mbi rezultatet e analizave të kryera nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit në këtë zonë;

Gjatë vitit 2024 Sektori i Zhvillimit Urban ka organizuar 5 (pesë) mbledhje të Këshillit të Basenit Ujor Mat, si dhe është bërë përpunimi i materialeve shkresore që kanë ardhur nga Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Mat, ose nga institucione të tjera në adresë të tyre.

Nga Prefekti i Qarkut Lezhë, më datën 15.05.2024, është organizuar mbledhja e Komitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura, për të realizuar një bashkërendim më efikas të institucioneve shtetërore, në përshtatje me ndryshimet e reja ligjore për zonat e mbrojtura. Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Prefektit të Qarkut Lezhë z. Gjergj Prendi ku u prezantuan ndryshimet dhe shtesat në ligjin Nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”. Në këtë aspekt u qartësuan funksionet dhe kompetencat e institucioneve vendore, si dhe nevoja për prezencën e policisë së shtetit dhe IKMT-së për monitorimin e situatës në territorin e zonave të mbrojtura.

Në kuadër të nismës “Shqipëria e pastër”, sektori i Zhvillimit Urban dhe administrata e Prefektit të Qarkut Lezhë, në bashkëpunim me Nënprefektin Kurbin dhe Mirditë, bashkinë Lezhë, me Drejtorinë Rajonale, Agjensitë dhe Inspektoratet Rajonale, organizuan aktivitetin e pastrimit në zonën e grykëderdhjes së lumit Drin, më datë 24.05.2024, në moton “Shqipëria e pastër”.

Në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 35, datë 19.02.2024 “Për përbërjen, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Task-Forcës për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve mbajtëse të Oxo-Degradueshme dhe Oxo-Biodegradueshme”, më datë 11.06.2024 Prefekti i Qarkut Lezhë zhvilloi një takim me përfaqësues nga Inspektorati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut, ARM Lezhë, drejtuesit e policive bashkiake Lezhë, Kurbin dhe Mirditë, lidhur me kordonimin dhe bashkëpunimin midis institucioneve pjesëmarrëse, për marrjen e masave për monitorimin, inspektimin e tregjeve lidhur me përdorimin e qeseve plastike. Gjatë gjithë kësaj periudhe ka patur komunikime zyrtare të vazhdueshme me institucionet përgjegjëse të sipërpërmëndura, lidhur me ecurinë e zbatimit të urdhërit.

Për zgjidhjen dhe trajtimin e çështjeve të sipërpërmëndura kemi bashkërenduar institucionet lokale, si drejtoritë rajonale, inspektoriatet, dhe njësitë e vetqeverisjes vendore për të krijuar grupe pune dhe takime, duke zhvilluar aksione, duke ndërhyrë në trajtimin e problematikave të mësipërme bazuar në kuadrin ligjor dhe nënligjor.

VENDIMET E NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE DHE TRAJTIMI I TYRE

Gjatë vitit **2024**, në Sektorin e Zhvillimit Urban nuk janë depozituar **vendime të njësive të qeverisjes vendore**.

TRAJTIMI I KORRESPONDENCES ME INSTITUCIONET DHE TË TRETËT

Gjatë këtij viti kemi trajtuar **63** shkresa të ardhura nga institucione dhe shtetas të ndryshëm, të cilëve u kemi kthyer përgjigje duke zbatuar afatet ligjore dhe duke kërkuar zgjidhjen sa më të shpejtë të problematikave të tyre. Nuk ka munguar bashkëpunimi dhe interesimi tek organet kompetente për trajtimin e kërkesë ankesave të shtetasve.

OBJEKTIVA TË SEKTORIT TË ZHVILLIMIT URBAN PËR VITIN 2025

- Zgjidhja e të gjitha problematikave që do të parashtrihen sipas dhe konform ligjit;
- Trajtimi i Vendimeve të Nj.Q.V-ve sipas procedurave ligjore dhe sqarimi juridik i tyre për të gjitha shkeljet e vërejtura;
- Zgjerimi i bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe vendore;
- Trajtimi dhe zgjidhja e problematikave të qytetarëve;
- Verifikimi në vend i vendimeve të marra nga organet e qeverisjes vendore;
- Ndjekja me prioritet e procesit të përfitimit të qytetarëve nga Grantet e Rindërtimit si rezultat i dëmeve të pësuar nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019, deri në përfundimin e plotë të këtij procesi;
- Vijimi i luftës ndaj fenomenit të shfrytëzimit të paligjshëm të inerteve.

5-SEKTORI I PLANIZIMIT DHE PËRBALLIMIT TË MBROJTJES CIVILE DHE KRIZAVE

Sektori i PPMC&K, funksionon në zbatim të ligjit nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, të ligjit nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", si dhe të akteve ligjore e nënligjore, në lidhje me zbatimin e detyrave në planifikimin dhe përballimin e situatave të emergjencave civile.

Gjatë vitit 2024, kemi ndjekur dhe menaxhuar situatat e emergjencave natyrore që kanë përshkuar territorin e qarkut, në zbatim të akteve të miratuara nga Prefekti, konkretisht;

- Urdhërin për ngritjen e funksionimit të Komisionit të PPMC&K;
- Planeve të Veprimt dhe të Masave, stinore;
- Planizimin vjetor të Sektorit të PPMC&K, etj .

Mbledhjet e komisionit të planifikimit dhe përballimit të mbrojtjes civile dhe krizave, në shkallë qarku, janë organizuar nën drejtimin e Prefektit dhe me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të komisionit, mbi marrjen e masave në planifikimin dhe përballimin e mbrojtjes civile dhe krizave, sipas ligjit dhe situatave emergjente.

Prefekti, në takimet me shtabin e MC, ka tërhequr vëmendjen mbi marrjen e masave dhe bashkëpunimin me operatorët në terren për menaxhimin dhe përballimin e situatave nga reshjet e shirave, dëborës, zjarreve dhe tërmetet.

Kemi organizuar takime pune me zyrat e mbrojtjes civile të bashkive për bashkëpunimin; këmbimin e informacioneve mbi situatat; mënyrën e plotësimit të dokumentacionit; si dhe sqarimet paraprake për përgatitjen e planeve të mbrojtjes civile në shkallë bashkie.

Një panoramë të situatave të emergjencave civile në shkallë qarku, për vitin 2024:

1. Tërmetet:

Gjatë këtij viti nuk kemi patur lëkundje të shumta tërmeti, kanë qenë dy lëkundje jashtë territorit të Qarkut tonë, por që janë ndjerë në territorin e qarkut tonë.

Ka vazhduar vazhduar puna nga bashkitë për plotësimin e dokumentacioneve për likuidimin e pasojave të tërmetit të datës 21.09.2019, në territorin e qarkut Lezhë, mbi dëmtimin e banesave sipas shkallëve të vlersimit DS1, DS2, DS3, DS4, DS5.

Janë përgatitur dosjet përkatëse, marrja e vendimeve dhe konfirmimi i tyre nga Institucioni i Prefektit të Qarkut për dëmshperblimin mbi dëmtimin e banesave, miratimin e listave për bonus qeraje, etj.

Nga tërmetet e këtij viti me lëkundje të ndjeshme kemi evidentuar:

Me datën 14.03.2023, ora 04:06 (GMT), Instituti i Gjeoshkencës, ka regjistruar një lëkundje tërmeti me magnitudë **ML= 5.4**, në koordinatat 41° 59' 37" N dhe 18° 40' 47" E, me thellësi 7.6 km dhe epiqendër në Pluzhine, në republikën e Malit të Zi.

Nga informacione e strukturave të mbrojtjes civile të bashkive Lezhë, Mirditë dhe Kurbin nuk u raportuan problematika.

Me datë 24.07.2024, ora 02:42:, Instituti i Gjeoshkencës, ka regjistruar një lëkundje tërmeti me magnitudë **ML= 4.6** Rihter në koordinatat 41.687 N dhe 19.493 E, me thellësi 10 km dhe epiqendër në detin Adriatik, në afërsi të Kepit të Rodonit.

Nga komunikimi me strukturat e mbrojtjes civile të bashkive Lezhë, Mirditë dhe Kurbin, nuk raportohen probleme.

Reshjet e Dëborës

Përsa i përket situatës së reshjeve të dëborës në muajt Janar-Shkurt dhe periudha tjetër Nëntor – Dhjetor, nuk kemi patur shumë problematika, pasi stina e dimrit ka qënë e butë.

Akset kryesore të rrjetit rrugor mirmbahen nga subjektet private, me të cilët ARRSH, në rolin e “pronarit” të rrugëve ka lidhur kontrata me to. Ne kemi listën e subjekteve private mirëmbajtëse, kjo listë u është vënë në dispozicion të gjitha Njësive Vendore, (bashkive), si dhe Drejtorisë Vendore të Policisë së Shtetit. Akset e tjera janë pronë e bashkisë dhe si të tilla mirëmbahen nga ato.

Vlen për tu theksuar që për çdo pritje për përkeqësim të situatës metereologjike nga ana e QOMC, pranë AKMC, jemi informuar në kohë përkëtë situatë. Ky informacion i ardhur nga QOMC, u është përcjellë në çdo rast me email bashkive, strukturave të MC të bashkive, Drejtorisë Rajonale të Ujitjes dhe Kullimit, Drejtorisë së Ujësijellës Kanalizimeve dhe OSHEE, Rajonit Verior të ARRSH, për rritjen e gadishmërisë dhe marrjen e masave përkatëse, për zvogëlimin e rrishtit nga fatkeqësitë e pritshme.

Reshjet e shiut

Gjatë vitit 2024 në qarkun Lezhë kanë rënë rreth 1448 mm shi, kryesisht gjatë muajve mars, (215 mm), maj (181 mm) dhe dhjetor (257mm), reshje në sasi të ndryshme ka patur për 96 ditë. Nga kjo sasi reshjesh nuk kemi patur përmbytje në toka bujqësore, por vetëm në zonat urbane kemi patur prezencë të ujit kryesisht në rrugë, si dhe prezencën e ujit në oborrin e një shtëpie në qytetin e Shëngjinit, në periudha afatshkurtëra, për shkak të kanaleve të largimit me dimensione të vogla. Kjo tregon që nga ana e Drejtorisë Rajonale të Ujitjes dhe Kullimit, strukturave bashkiake, janë marrë masa për pastrimin e kanaleve dhe mirmbajtjen e argjinaturave.

Gjatë kësaj periudhe nuk kemi patur sasi reshjesh të mëdha, sasia më e madhe reshjeve është regjistruar me datën 05.10.2024, me **56 mm shi**, kjo ka sjellë jo pak anomali në qarkullimin e mjeteve dhe njerzeve, sidomos në qytetet Lezhë, Shëngjin e Laç, si dhe dëmtimin e linjave elektrike të zonave rurale, si dhe prezencë uji në një banesë në Shëngjin.

Ndërrhyrjet e strukturave të EC të bashkive, MZSH, OSHEE, Drejtorirë Rajonale të Ujitjes dhe Kullimit, bënë që të kthehet normaliteti në rrugët e qendrave të banuara, si dhe largimi i ujit nga banesa në qytetin e Shëngjinit.

Sasia e rreshjeve gjatë muajt Janar 2024 ka qënë 137 mm shi e shpërndarë në 11 ditë. Gjatë këtij muaji nuk kemi patur problematika përsa i përket përmbytjeve.

Sasia e rreshjeve gjatë muajt Shkurt 2024 ka qënë 56 mm shi e shpërndarë në 6 ditë. Gjatë këtij muaji nuk kemi patur problematika përsa i përket përmbytjeve.

Sasia e rreshjeve gjatë muajt Mars 2024 ka qënë 215 mm shi e shpërndarë në 14 ditë. Gjatë këtij muaji nuk kemi patur problematika përsa i përket përmbytjeve.

Sasia e rreshjeve gjatë muajt Prillë 2024 ka qënë 118 mm shi e shpërndarë në 8 ditë. Gjatë këtij muaji nuk kemi patur problematika përsa i përket përmbytjeve.

Sasia e rreshjeve gjatë muajt Maj 2024 ka qënë 181 mm shi e shpërndarë në 14 ditë. Gjatë këtij muaji nuk kemi patur problematika përsa i përket përmbytjeve.

Sasia e rreshjeve gjatë muajt Qershor 2024 ka qënë 41 mm shi e shpërndarë në 4 ditë. Gjatë këtij muaji nuk kemi patur problematika përsa i përket përmbytjeve.

Sasia e rreshjeve gjatë muajt Korrik 2024 ka qënë 00 mm shi, para anjë ditë me reshje.

Sasia e rreshjeve gjatë muajt Gusht 2024 ka qënë 12 mm shi e shpërndarë në 2 ditë.

Sasia e rreshjeve gjatë muajt Shtator 2024 ka qënë 179 mm shi e shpërndarë në 9 ditë. Gjatë këtij muaji nuk kemi patur problematika përsa i përket përmbytjeve.

Sasia e rreshjeve në muajt Tetor 2024, deri tani ka qënë 125 mm shi e shpërndarë në 8 ditë. Gjatë këtij muaji nuk kemi patur problematika përsa i përket përmbytjeve në tokat bujqësore, por

shirat e datës 05.10. 2024 sollën problematika në qarkullimin e mjeteve dhe njerëzeve në rrugët e qyteteve Lezhë, Shëngjin, Laç, si dhe defekte të shumta në linjat e furnizimit me energji elektrike, sidomos zonat rurale.

Sasia e rreshjeve në muajt Nëntor 2024, deri tani ka qenë 127 mm shi e shpërndarë në 9 ditë. Gjatë këtij muaji nuk kemi patur problematika përsa i përket përmbytjeve.

Sasia e rreshjeve në muajt Dhjetor 2024, deri tani ka qenë 257 mm shi e shpërndarë në 11 ditë. Gjatë këtij muaji nuk kemi patur problematika përsa i përket përmbytjeve.

Problem nga rreshjet kemi në zonat urbane, ku kemi bum ndërtimesh, për largimin e ujrave të bardha e janë ato kanale që kanë qenë para ndërtimit të këtyre pallateve, etj. Kjo sjell prezencë të ujit në rrugë, oborre shkollash, etj, në afate të shkurtëra kohore. Kemi problema në dy akse rrugore, njëra është tek kryqzimi i Shëngjinit me rrugën nacionale Laç – Lezhë dhe tjetra është në rrugën për në fshatin Ishull Shëngjin, tek nënkalimi me suerstradën Laç-Lezhë. Për të dy këto akse i jemi drejtur ARRSH për dhenjen e zgjidhjeve teknike.

Nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut është kërkuar në mënyrë të vazhdueshme marrja e masave për pastrimin e pusetave të largimit të ujrave të bardha, në qëndrat e banuara, pastrimin e kanaleve, kolektorëve, tombinove, urave etj, si dhe mbajtja nën monitorim të vazhdueshëm ujëmbledhës, digat e tyre, shkrakuesit katastrofik, pasi çarja e tyre shkakton katastrofa njerzore e materiale, etj.

Zjarret.

Situata e zjarrëve në shkallë qarku, mbetet problematike, por kjo problematikë sa vjen e rritet çdo vit, kjo e ardhur si rezultat i ndryshimeve klimaterike, por dhe mos sinjalizimit, informimit dhe rrjedhimisht dhe reagimin jo në kohë.

Takimet përgatitore më komisionet e MC në bashki, kanë ndikuar deri në një farë mase në parandalimin e shfaqjes së vatrave të zjarrit.

Nga Prefekti, është kërkuar marrja e masave të nevojshme për mbrojtjen nga zjarri gjatë sezionit turistik veror 2024, në të gjithë vijën bregdetare dhe ato malore, duke caktuar dhe kontrolluar grupet e vrojtimit-sinjalizimit, përmirësimin e sistemit të lajmërimit e ndërlidhjes në të gjithë territorin, nëpërmjet policisë, shërbimit pyjor, drejtuesve të njësisve administrative, kryetarëve të fshatrave etj, si dhe mbajtja në gadishmëri, të kapaciteteve njerzore, mjeteve teknike të strukturës së MZSH-së, hidrantët nga drejtoria e ujësjellës - kanalizimeve për furnizimin me sasinë e nevojshme të ujit në çdo situatë zjarresh, kompletimi sipas institucioneve, me bazën e nevojshme materiale për shuarjen e zjarreve nga bashkitë.

Nga ana e Prefektit të Qarkut është kërkuar që nga Njësitë Vendore të organizohen takimeve sensibilizuese në çdo njësi administrative dhe mundësisht në çdo fshat, për ndërgjegjësimin e popullatës, sensibilizimin e tyre, rritjen e pjesmarrjes së vullnetarëve, etj.

Numri zjarreve gjatë vitit 2024 është: 690 raste të ndara:

- Objekte total	127
- Objekte, private të ndryshme	126
- Objekte Didaktike (shkolla,kopshte,çerdhe)	1
- Mjete transporti	34
- Kullota, pyje, Shkurre, ferra, barishte, plehra	451
- Ndërhyrje për shpëtim	64
- Alarme false	1
- Nuk ka qenë e nevojshme ndërhyrja	13
-	

- Kemi 9 raste, ku zjarret kanë zgjatur nga **3 deri në 14 ditë**, të cilat kanë sipërfaqen përbëjnë sipërfaqen më të madhe të përshkruar nga zjarri, si më poshtë:

1. Zjarri në Malin e Kakarriqit 24.07-04.08.2024, 11 ditë, ku përshkuan nga zjarri rreth 1637 ha
2. Zjarri në Malecaj-Mal Rrenci, 24-29.07.2024, zgjati 5 ditë, ku përshkuan nga zjarri rreth 923 ha
3. Zjarri në Mal Shëngjin-Shëngjin 27.07-04.08.2024, zgjati 5 ditë, ku përshkuan nga zjarri rreth 278 ha
4. Zjarri në Mal Bardhë-Skuraj, 28.08-07.09.2024, zgjati 11 ditë, ku u përshkuan nga zjarri rreth 30 ha.
5. Zjarri në Skuraj, Kurbin 07-15.08.2024, zgjati 8 ditë, me riaktivizim të herë pas hershëm, ku u përshkuan nga zjarri rreth 70 ha.
6. Zjarri në Shmëri, Orosh, Mirditë 21-25.07.2024, zgjati 3 ditë, ku u përshkuan nga zjarri rreth 39 ha
7. Zjarri në Bardhaj, Selitë, Mirditë 12-14.08.2024, zgjati 4 ditë, ku u përshkuan nga zjarri rreth 18 ha.
8. Zjarri në Fush Lugje, Orosh, Mirditë 17-19.08.2024, zgjati 3 ditë, ku u përshkuan nga zjarri rreth 107 ha
9. Zjarri në Shëngjin të Fanit-Lajthizë të Oroshit, Mirditë 27.08-09.09.2024, zgjati 14 ditë, ku u përshkuan nga zjarri rreth 650 ha.

Por jo pak të frikshme dhe me pasoja ishin dhe zjarret në fushën e Zadrimës, si në Baqel-Krajen, me 164 ha per rreth 5 orë, apo Dajç me rreth 45 ha për rreth 5 orë, zjarr i rënë në të njëjtën ditë dhe kohë,(26.08.2024), duke rrezikuar seriozisht shtëpi banimi por duke djegur e shkrumbuar shumë magazine e depo familjare, apo pacela të tëra me pemë frutore, ullishte e vreshta etj.

Zjarr i frikshëm është ai i datës 27.08.2024, i rënë në fshatin Kallmet, në orën 21:00 të, me kohëzgjatje 2 ditë, ku u përshkuan nga zjarri rreth 52 ha pyll me pisha,etj.

Duhet theksuar se zjarret me të mëdha në numër kanë qene gjatë muajve Korrik-Gusht-Shtator (15 Korrik-15 Shtator)

Në të gjitha rastet e zjarreve problematike, (ku rrezikoheshin banesat), kemi patur mbështetjen e pakursyer të AKMC dhe DPMZSH, me mjete forca toksore,(deri në 29 mjete zjarrfikëse dhe deri 348 efektiv të FA) si dhe me mjete ajrore helikopter të FA dhe avion tipit CANADIR dhe SPARTAN 27, nga mekanizmi europian i MC, kjo ka bërë të mundur që të mos kemi anjë humbje jete.

Mund të themi pa frikë që nata e datës 29.07.2024, dhe dita e datës 30.07.2024 mund ti quajmë nata e ferrit dhe dita e ferrit, me situatën që kaluam në Shëngjin.

Këto zjarre kanë qenë në përgjithësi të qëllimshme dhe nga pakujdesitë e banorëve, të cilëve ju ka dalë situata jashtë kontrollit gjatë djegeve të kashtës, ferrave etj.

Krahasuar me vitin 2023, zjarret në vitin 2024 kanë përshkruar mbi 30 fishin e sipërfaqes.

Me situatën që kaluam mendoj se duhet të nxjerrim dhe mësim, duke analizuar ato që bëjnë mirë dhe ato që duhet ti bëjmë më mirë, si tek:

1. Mos funksionimi si duhet i sinjalizueve, si dhe raportimi në kohë për zjarret.
2. Mungesa e ujit në hidrante nuk është fare normale.
3. Mungesa e autobotëve për furnizimin e mjeteve zjarrfikëse, (29 zjarrfikëse me 4 autobote, në rastin e Shëngjinit)
4. Mungesa e aktivizimit të kapaciteteve të deklaruara.

5. Mungesa e aktivizimit të vullnetarëve të deklaruar në fshatra.
6. Mos pasja e koridoreve pyjore për pritrat e zjarrit, apo mos pastrimi i tyre.
7. Mos hapja e rrugëve pyjore, dhe mirmbajtja e tyre.
8. Mos pasja e makinave të vogla, 4x4 me depozita deri 1000 l për tu futur rrugë e pa rrugë, sa më afër vatrës së zjarrit.
9. Në çdo situatë sa do të përballueshme që të jetë, pa shfrytëzuar kapacitetet lokale, kërkohet ndihmë nga FA. Kur vijnë në ndihmë forcat operacionale të MM, apo MB, me përjashtim të strukturave zjarrfikëse, të gjithë strukturat e tjera vendore zhuken, a thua se këto forca janë marrë për argat e jo për ndihmë.
10. Mendojmë që në çdo bashki (stacion MZSH), të ketë një mjet me pompë për furnizimin e mjeteve zjarrfikëse, në çdo vend që ka ujë, si modeli i makinës së bashkisë Tiranë, që ishte në Shëngjin.

Rrugët nacionale.

Në inventar të bashkive të Qarkut tonë kemi gjithësej **1513 km rrugë**, të ndara:

1. Bashkia Lezhë 936 km, nga të cilat 370 km të asfaltuara, 566 km të pa asfaltuara.
2. Bashkia Kurbin 94.4 km, nga të cilat 42.7 km të asfaltuara, 51.7 km të pa asfaltuara.
3. Bashkia Mirditë 482.6 km, nga të cilat 91.4 km të asfaltuara, 388.5 km të pa asfaltuara.

Siç jeni dhe ju në dijeni situara e reshjeve në shumë raste janë me intensitet shumë të lartë për një kohë të shkurtër, gjë e cila sjell përmbajtje në kohë të shkurtër, kryesisht në zonat urbane, qytete, por ka raste që rrezikohen dhe akset rrugore, etj.

Të gjitha akset rrugore nacionale, janë të kontraktuar me subjektet privatë për mirmbajtje, qoftë për pastrim e largim materialeve inerte, apo për pastrim nga dëbora e kriposjen e tyre, kurse akset rurale dhe një pjesë e akseve nacionale janë në inventar dhe mirmbajtje nga Bashkitë, bazuar në **Vendimin Nr. 234, datë 17.4.2024** “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 600, datë 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për pronësinë e rrugëve Shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve”

ARRSH në bashkëpunim me strukturat e policisë rrugore duhet që të evidentojnë pikat problematike që paraqesin këto akse dhe të ndërhyjë për rehabilitimin e tyre

Firmat kontraktore që mirëmbajnë akset rrugore nacionale, duke marrë parasysh situatën e krijuar në vitet e mëparshme, duhet të kenë rezerva të kripës për këtë aks, si dhe mjetet e nevojshme në gadishmëri.

Tabela me subjektet private të kontraktuara për mirmbajtjen e akseve nacionale, ju janë vënë në dispozicion Drejtorisë Vendore të Policisë së Shtetit si dhe bashkive.

Pjesmarrja në takime të ndryshme:

1. Nën drejtimin e Prefektit të Qarkut Lezhë janë zhvilluar mbledhjet e Komisionit të MC në nivel Qarku, sipas fazave Pravere dhe Vjeshte
2. Nga ana e AKMC është zhvilluar Moduli i Trajnimit Baze të Mbrojtjes Civile për Strukturat e Mbrojtjes Civile në Nivel Qarku dhe Bashkie, datat 4-5.04.2024, në Lezhë.
3. Nën drejtimin e Prefektit të Qarkut Lezhë janë zhvilluar takim me subjektet kontraktore për mirmbajtjen e rrugëve nacionale që kalojnë në teritorin e Qarkut Lezhë.
4. Bazuar në Planin e Punës së Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, nr.6770, datë 11.06.2024, me datë 18.06.2024, në ambjentet e Bibliotekës së bashkisë Lezhë, nga

5. Drejtoria e Pergjithshme e MZSH-së, Tiranë, në ambjentet e bashkisë Lezhë u organizua një takim pune me temë : "Mbi marrjen e masave për parandalimin, rritjes bashkëpunimit dhe përballimin e situatave të zjarreve gjatë stinës së verës në sipërfaqet pyjore dhe kullota".
6. Me ftesë të AKMC, Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë, (Sektori i PPMC&K), në rolin e vëzhguesve, mori pjesë në stërvitjen funksionale (CPX) "PËRGATITJE DIMËRORE - 2024" me strukturat e Mbrojtjes Civile në nivel Qëndror dhe Rajonal, të Qarkut Dibër dhe Qarkut Kukës.
7. Me datë 30.10.2024, në zbatim të prioriteteve qeveritare për menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë, të ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", të VKM-së Nr.807, datë 28.12.2023 "Planit Kombëtar për Emergjencat Civile", referuar planifikimit buxhetor afatmesëm PBA 2025-2027, faza e dytë, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile thirri mbledhjen e Komisionit të Mbrojtjes Civile të Qarkut Lezhë.
8. Me datën 30.10.2024, ora 10:00, në ambjentet e Bibliotekës Publike "Gjergj Fishta", Lezhë, me mbështetjen e Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë, nga Qendra Ndëristitucionale Operacionale Detare, (QNOD), strukturë e Ministrisë së Mbrojtjes, me qendër në Durrës, u organizua trajnim me temë: "Plani i masave dhe organizimi i grupeve të punës në terren, për reagimin ndaj ndotjes detare shkalla I, II dhe III,
9. Me datë 16.05.2024, në zbatim ", Urdhërit e Prefekti të Qarkut nr.21, datë 21.03.2024, "Për Ngritjen e Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Mbrojtjes Civile dhe Krizave" në nivel qarku si dhe të planit të masave "Për parandalimin dhe përballimin e situatave emergjente që krijohen nga rënia e zjarreve gjatë vitit 2024", në ambjentet e Institucionit të Prefektit, nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm z.Illir Ndoka, sektori Planifikimit Përballimit të Mbrojtjes Civile dhe Krizave organizoi një takim pune me drejtuesit e strukturave përgjegjëse të mbrojtjes civile, në nivel qarku, konkretisht:
 - drejtuesit e strukturave të mbrojtjes civile të bashkive Lezhë, Mirditë dhe Kurbin.
 - drejtuesit e strukturave të MZSH-ve, në bashkitë Lezhë, Mirditë dhe Kurbin
 - përfaqësues të AKMC-së për rajonin e veriut.
 - shefi i sektorit për rendin dhe sigurinë publike në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë.
 - drejtuesit e strukturave përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashkitë respektive
 - Adzm Lezhë.
9. Me datën 18-21.11.2024 kemi marrë pjesë në trajnimin e orgaizuar nga UNDP "Mbi Manaxhimin e e Riskut nga Permbytjet".
10. Kemi marrë pjesë në mbledhjet e KMC të bashkive Lezhë e Mirditë
11. Kemi marrë pjesë në disa konferencat planizuese te organizuar nga AKMC, në lidhje me stërvitjen "Flood North", Albania që do të organizohet në Prill 2025, në rajonin e Shkodrës., etj.
12. Për Vlerësimin e Nevojave pas Fatkeqësive dhe Planifikimin e Rimëkëmbjes në Shqipëri".
13. Me ftesë të Nënkolonel Ali MALI, Komandant i Rregjimentit të Këmbërorisë së Veriut, SHPFA, morëm pjesë në aktivitetin "Ditë e hapur" e Forcave të Armatosura, në ambjentet e Regjimentit të Veriut, Vau Dejës.

Të ndryshme:

Për rastet e konstatuara mbi monicionet e gjetura në teritorin e Qarkut, janë bërë kërkesa nga Institucioni i Prefektit në AKMC për specialist xhenjer të EOD, të Forcave të Armatosura të Ministrisë Mbrojtjes mbi çaktivizimin dhe tërheqjen e tyre.

-Kontakti me mediat për rastet e situatave të emergjencave civile, ka qenë korrekt.

-Kemi marrë pjese në mbi 13 takime, seminare e trajnime, në përgatitje profesionale.

- Është ndjekur korrespondenca mbi hyrjen-dalje e **152** shkresave, në kohë e me korretësi.
- Janë konfirmuar **22** vendime të bashkive Lezhë, Kurbin e Mirditë;

Përballja në vite me fatkeqësitë natyrore, kanë krijuar një frymë të mirë bashkëpunimi në mes strukturave të mbrojtjes civile, çka tregon mundësinë e planifikimit, përballimit dhe menaxhimit të tyre me sukses nga KPPMC&K, por është e domosdoshme që strukturat e qeverisjes vendore në disa raste duhet të jenë më korrekt në raportime, përfund të fundit është detyra e tyre ligjore për informim në strukturat e Prefekturës dhe jo dëshirë.

PRIORITETET E INSTITUCIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT LEZHË PËR VITIN 2025

- 1.RESPEKTIMI I KUADRIT LIGJOR PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT QEVERITAR NË SIGURINË PUBLIKE, SHËNDETËSI, TURIZËM, PUNËSIM, BUQËSI, MBROJTJEN E MJEDISIT DHE MBROJTJEN CIVILE.**
- 2.RRITJA E PËRGJEGJËSISË DHE ANGAZHIMI I STRUKTURAVE PËRKATËSE NË PLANIFIKIMIN DHE MARRJEN E MASAVE PËR PARANDALIMIN E SITUATAVE TË MUNDËSHME EMERGJENTE DHE KRIZAVE NË QARK GJATË VITIT 2025.**
- 3.NDJEKJA E SITUATËS SË PASTËRMET (RINDËRTIMI) GJATË VITIT 2025 DHE NDJEKJA E MASAVE PËR ZBATIMIN E VENDIMEVE TË QEVERISË.**
- 4.VERIFIKIMI I LIGJISHMËRISË SË AKTEVE ME KARAKTER NORMATIV TË ORGANEVE TË NJËSIVE TË VETQEVERISJES VENDORE DHE ZBATIMI I LIGJISHMËRISË NË VEPRIMTARINË E INSTITUCIONIT TË PREFEKTIT.**
- 5.SHQYRTIMI I ANKESAVE DHE KËRKESAVE TË QYTETARËVE DUKE I ADRESUAR DREJT ZGJIDHJES LIGJORE.**
- 6.RRITJA E PËRFORMANCËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE NË NIVEL QARKU.**

Sekretari i Përgjithshëm. I.Ndoka

Sek.Mon.Komp.Vend. : P.Lani

Sek.Juridik : B.Molla

Sek.Financ.Sherb.Mbesh : S.Filipi

Sek.Mbrojtes Civile : Nikoll Tushi

Sek.Zhvillimit Urban : Gentjan Liçaj